



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KRUJE**

RELACION TEKNIK

“Rikonstruktion i Shkollës Thumanë +
Ndertim Palestër “



RELACION

RIKONSTRUKSION I SHKOLLËS THUMANË + NDERTIM PALESTËR

POZICIONI ORTOFOTO



- ***Qellimi i projektit***

Si rezultat i lëkundjeve sizmike të datës 04.07.2018, midis shumë objekteve ndërtimore të dëmtuara, është dëmtuar shumë dhe shkolla e mesme e bashkuar “Ramazan Jangozi” në Njesinë Administrative Thumanë, e cila që mëparë ishte shumë e dëmtuar, si pasojë e amortizimit dhe e mosinvestimit ndër vite, por që në këto momente zhvillimi i procesit mesimor në këto ambiente është bërë i rrezikshëm për sigurinë e nxënësve.

- **Gjendja ekzistuese**

Në Thumanë aktualisht janë dy shkolla, shkolla 9-vjeçare dhe shkolla e mesme, që i korespondojnë dy godinave, godina e re 3 kate ku aktualisht zhvillohet procesi mësimor për arsimin parashkollor, 9-vjeçar të mesëm dhe godina e vjetër 2kat, që aktualisht nuk zhvillohet proces mësimdhënie për arsye sigurie, si rrjedhojë e dëmtimit të saj nga amortizimi ndër vite dhe nga tërmeti i mësipërm , po që më parë përdorej për procesin e mësimdhënies për arsimin parashkollor dhe fillor.

Në godinën 2 kat, para dëmtimit të fundit nga tërmeti, zhvillohej procesi mësimor për arsimin parashkollor dhe fillor, vetëm në tre ambiente të saj, ndërsa 4 klasa ishin totalisht të dëmtuara si pasojë e amortizimit ndër vite.

Godina e vjetër 2 kate është ndërtuar rreth viteve 70 dhe që nga ajo periudhë nuk është investuar duke e kthyer në një objekt mjaft të amortizuar ku procesi i mësimdhënies është pezulluar për arsye sigurie.

Numri i nxënësve në total, që studiojnë në këto shkolla është rreth 550 nxënës, të ndarë;170 nxënës (parashkollore dhe fillor) tek shkolla e vjetër 2kat dhe rreth 380 nxënës studiojnë tek shkolla 3 kat (fillorë dhe e mesme).

Kati përdhe 280 m²:

Klasa te Pergjithshme_	3 klasa
Banjo	6 copë
Ambjente sherbimesh	2 copë
Korridor	

Kati i parë 280 m² :

Klasa te Pergjithshme_	4 klasa
Salle mesuesish	1 copë

Korridor

Ambientet qe disponon shkolla ne total jane:

Klasa te Pergjithshme = 3 klasa aktuale, 4 klasa të dëmtuara, në total 7 klasa.

Per rrjedhoje, shkolla nuk realizon sic duhet funksionin baze te saj si institucion edukativ. Si pasojë e numrit të madh të nxënësve dhe e ambienteve të pamjaftueshmë për mësimdhënie (duke i konsideruar të dy godinat aktive), procesi mësimor në godinën 3 kat zhvillohet me turne, duke kaluar 3 klasa mbasdite, pasi edhe para dëmtimit të godinës 2kat nga tërmeti, mësimdhënia në 4 klasa të saj nuk zhvillohej pasi ishin mjaft të dëmtuara.



Open
Procurement
Albania













- ***Propozimi***

Ndodhur në këto kushte, bashkia Krujë ka hartuar projekt preventivin për rikonstrukcionin e godinës së vjetër 2kat, e cila do të zgjidhte njëherë e mirë procesin e mësimdhënies për arsimin parashkollor, 9-vjeçar dhe të mesëm, duke eliminuar dhe procesin e mësimdhënies me turne, pasi restaurimi i saj do të krijojë 4 ambiente të reja veç ambienteve ekzistuese si dhe do të bëjë të mundur dhe ndërtimin e 6 banjove të reja.

Po ashtu, në këtë projekt është parashikuar dhe ndërtimi i një palestre të re me sipërfaqe 350m², e cila do ti shërbente dy shkollave respektive, ku aktualisht të dy shkollat janë pa palestër.

**RAPORTI TEKNIK
U PERGATIT NGA STUDIO „XH&MILER“SH.P.K**

Ing. Xhulieta Duro